

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përplasja për rregulloren, GJKKO në kolaps, 3 javë pa gjyqe
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/perplasja-per-rregulloren-gjkkko-ne-kolaps-3-jave-pa-gjyqe-i589004
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:23:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 17:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d48c562bc2d8a0793ba05a7c48942b7b5ae080d1fcd2a6527c97c66a8c4e0b0e
TEKSTI	f99089f34f5adbcc3ea94cb6e37a19c8010dcc15bf1caf63badc7b426b9d5cb
PAMJA	87c9cc6c57d0390f2551e5e25b87488c2743a67588dad595ce07720b41c3b3bb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d245469e6b2f4f9940859fee4bc2c134bec8a92aa36750e83fe28bb8e104f93d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d245469e6b2f4f9940859fee4bc2c134bec8a92aa36750e83fe28bb8e104f93d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

le "A doni te blini arme nga SHBA?" - Trump ia beri pyetjen Xi Jinping. Departamenti i Shtetit jep sqarimin "Specialja kriminalizoi procesin", analisti Pa ikur Kurti nga pusht fundit

Përplasja për rregulloren, GJKKO në kolaps, 3 javë pa gjyqe

TemA

28 Shtator 2026, 19:00Kronika TEMA



Gjykata e Posaçme është futur në një ngërc funksional. Prej tre javësh në të nuk është zhvilluar asnjë gjykim në themel. Proceset kanë dështuar për shkak të bojkotit të avokatëve, që kërkojnë rishikim të një rregulloreje të gjykatës. Nga e hëna, avokatët nisën bojkot edhe të seancave të masave të sigurimit.

Një rregullore e re e brendshme në Gjykatën e Posaçme, që nisi të zbatohet prej datës 1 shtator, po e çon këtë gjykatë në kolaps. Të hënën, radha e dështimit të gjyqit i ra mes të tjerëve dosjes "Partizani", kryebashkiakut të Shkodrës, apo edhe Emiliano Shullazit. Proceset në GJKKO, janë në ngërc prej 8 shtatorit, kur avokatët vendosën të bojkotojnë çdo gjykim në themel. Mes bojkotit mbrojtësit kërkojnë rishikim të rregullores, që sipas tyre, i kufizon në ushtrimin e profesionit të avokatit.

Për më shumë se dy javë, bojkoti i avokatëve u injorua nga Gjykata e Posaçme. Në disa seanca mbrojtësit u gjobiten nga gjykata me nga 10-50 mijë lekë me arsyetimin e mungesës së papërligjur.

Më 23 shtator avokatët përshkallëzuan revoltën, duke vendosur të bojkotojnë edhe seancat për caktimin, vlerësimin apo zëvendësimin e masave të sigurisë. Bojkoti total nisi nga e hëna. Në të njëjtin vendim, Dhoma e Avokatisë tërhoqi listën e avokatëve kryesisht nga Gjykata e Posaçme, duke e lënë thatë nga mbrojtësit. Kjo do të thotë, se nëse një i arrestuar nga SPAK shkon për masë sigurie në gjykatë, ai do të mbetet pa mbrojtje, duke ju mohuar kështu një e drejtë kushtetuese. Ditën e parë të bojkotit total nga avokatët në GJKKO nuk pati masa sigurie, ndërsa nuk është e qartë si do të veprohet prej saj në ditët në vijim. Për ironi, në të njëjtën godinë, në Gjykatën e Posaçme të Apelit, që ka një tjetër rregullore, proceset vijojnë normalisht.

E ndërsa avokatët kërkojnë rishikimin e rregullores dhe gjykata nga ana tjetër nuk bën hapa pas, të humburit e mëdhenj janë të pandehurit, që më së paku po ju zvarriten proceset gjyqësore. Për ata janë në masën e sigurisë "arrest në burg", me apo pa faj, po ju zgjatet koha e qëndrimit në qeli./A2



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Zjarr masiv në kodrat me ullishta në Kreshpan të Fierit, era e fortë po ndihmon në përhapjen e flakëve](#)

17:50 Kronika

[Kreu i komanduar i SHISH shfaqet për herë të parë në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, Elvis Lila me karrierë 20-vjeçare në shërbimin e inteligjencës](#)

15:20 Kronika / 5 komente

Alarm për WhatsApp-in - AKSK paralajmëron për kompromentim llogarish dhe apelon për kujdes të shtuar

14:50 Kronika

Operacioni "Cooperation": Zbardhen 6 vjedhje në Kavajë, në pranga 2 të dyshuarit

14:20 Kronika



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.